



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Primiçeno/Prodato Received/Delivery	07.02.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMBSHCK	1574/2023		114



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.1201/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.1201/2022 të datës 15.12.2022 të parashtruar nga ankuesi

në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 07.02.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1201/2022 e datës 15.12.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit të ankuesit me numër Nr.3508/2019 për pozitën "Zyrtar i lartë i logjistikës" në Departamentin e Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme.
- III. Mbetet në fuqi Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt emërimi të ankuesit me numër Nr.39/2015 i datës 09.01.2015 për pozitën "Zyrtar i lartë për siguri njërzore" në Departamentin e Rinisë.
- IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh, duke e kthyer ankuesin Labinot Berisha në pozitën "Zyrtar i lartë për siguri njërzore" në Departamentin e Rinisë, në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit sipas Ndryshim Plotësimit të Akt emërimit me numër Nr.39/2015 të datës 09.01.2015, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim

pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesi ka qenë i punësuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit sipas Akt emërimit me numër Nr.39/2015 të datës 09.01.2015 për pozitën "Zyrtar i lartë për siguri njerëzore" në Departamentin e Rinisë.

Komisioni Disiplinor në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me datën 20.03.2019 ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.01/2019, sipas të ankuesit cilit i është shqiptuar masa disiplinore "Largim nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër dhe ndalimi i gradimit për periudhën tri (3) vite. Mbi këtë bazë ankuesit edhe i është lëshuar Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit me numër Nr.3508/2019 për pozitën "Zyrtar i lartë i logjistikës" në Departamentin e Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme.

Pas kalimit të aftit të masës disiplinore, ankuesi vazhdimisht që nga muaji maj i vitit 2022 ka kërkuar përmes e-mailave zyrtar që të kthehet në pozitën e mëparshme, ku ajo e fundit ka qenë me datën 29.11.2022 përmes së cilës i është drejtuar Udhëheqësit të personelit në MKRS lidhur me marrjen në posedim të dosjes së tij dhe rikthimin në pozitën sipas së cilës e ka mbajtur me akt emërim dhe atë si "Zyrtar i lartë për siguri njerëzore" në Departamentin e Rinisë, pas përfundimit të masës disiplinore me datën 13.05.2022.

Pas heshtjes nga ana e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe mos përgjigjes lidhur me kërkesën e ankuesit, ky i fundit bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 15.12.2022, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 8098/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër aktit të mos veprimit të MKRS-së, i njëjti kërkon që ti aprovohet ankesa në tërësi dhe ta detyroj MKRS-në që ta kthej në pozitën të cilën e ka mbajtur si Zyrtar për siguri njerëzore ne Departamentin e Rinisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konform dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 22.12.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa me datën 05.01.2023, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga kjo e fundit së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me datën 27.01.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK/2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit Labinot Berisha edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me Nr.Prot.8098/2022 të datës 15.12.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.01/2019 të datës 20.03.2019 të Komisionit Disiplinor të MKRS-së; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të ankuesit**



Nr.3508/2019 të datës 16.08.2019; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të ankuesit Nr.39/2015 të datës 09.01.2015; E-mailat zyrtar të datës 05.12.2022, 29.11.2022, 04.07.2022, 16.05.2022, 04.07.2022; Shkresën zyrtare të datës 22.03.2019; Emailat zyrtar të datës 22.03.2019, 21.03.2019; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 22.12.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 05.01.2023 nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Vendimin Nr.767/2019 të datës 08.05.2019 i nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i MKRS-së.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar,  
*sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit të shkresave të lëndës dhe pas analizimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datën 20.03.2019 ka nxjerrë Vendimin Nr.01/2019 sipas të cilit ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore *“Largim nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër dhe ndalimi i gradimit për periudhën prej tri (3) viteve”*, nën dyshimin se i njëjti ka shkelur rëndë kodin e mirësjelljes në shërbimin civil.

Ndërlidhur me rastin e ankuesit, Kolegji ka konstatuar se ankuesit masa disiplinore *“Largim nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër dhe ndalimi i gradimit për periudhën prej tri (3) viteve”*, i është shqiptuar me datën 20.03.2019, ndërsa me datën 20.03.2022 kësaj mase i ka kaluar afati i vlefshmërisë prej tri vitesh dhe rrjedhimisht e njëjta është konsumuar. Andaj nisur nga ky konstatim institucioni i punësimit respektivisht Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka qenë e obliguar që ankuesin ta kthej në vendin e tij të punës pas kërkesës së ankuesit për kthim në pozitën të cilën e ka mbajtur sipas Plotësimit dhe Ndryshimit të Akt emërimit me numër Nr.39/2015 të datës 09.01.2015 për pozitën *“Zyrtar i lartë për siguri njerëzore”* në Departamentin e Rinisë, prandaj edhe pretendimi ankimor i ankuesit ndërlidhur me këtë çështje është i bazuar dhe ligjor.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nisur nga faktet e prezantuara si më lartë, konstaton se Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është i obliguar që ankuesin ta kthej në pozitën *“Zyrtar i lartë për siguri njerëzore”* në Departamentin e Rinisë, në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit sipas Ndryshim Plotësimit të Akt emërimit me numër Nr.39/2015 të datës 09.01.2015 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar si në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21,23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.1201/2022, datë 07/02/2023

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtarë e lartë për bashkëpunim profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.